



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:201557

Datë: 09.12.2019

Numri i dokumentit: 00734690

P.nr.980/2019

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me procesmbajtësen Erza Shamolli, praktikante, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1601-3/2019 e dt.12.09.2019, në çështjen penale kundër të pandehurave S.R, N.R dhe K.R që të tre nga fshati ..., Komuna Shtime, të akuzuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Avdullah Abedini të pandehurave, me datën 09.12.2019 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurave:

1. I pandehuri **S.R**, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, i lindur me datën ..., nga i ati Rr... dhe e ëma Z..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri me numër personal ...

2. I pandehuri **N.R**, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, i lindur me datën ..., nga i ati Rr... dhe e ëma Z..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i një fëmije , i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri me numër personal....,-

3. I pandehuri **K.R**, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, i lindur me datën ..., nga i ati Rr... dhe e ëma Z..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri me numër personal ..., -

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse me datën 16 Gusht 2019, rreth orës 21:50 h, në Rajonn Ekonomiko-PyJOR Mollopolc, në vendin e quajtur "A...", me qëllim të vjedhjes në bashkëkryerje me sharrë motorike kanë prerë dru të llojit ah, me vëllim të përgjithshëm, prej 2.49 metër kub, të cilat i ka transportuar me kuaj, me ç' rast Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna Shtime, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 380.97 Euro,-

- Me çka në bashkëkryerje kryen veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 31, 38, 39, 43, 69,70, 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe nenit 453 par.4 të KPPRK-së të pandehurit i

G J Y K O N

M E D Ë N I M M E G J O B Ë

I. Të pandehurit **S.R**, i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej 100 (njëqind) Euro, të cilin dënim me gjobë, nga rrethanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një periudhë prej dy muajve, konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

II. Të pandehurit **N.R**, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) Euro, të cilin dënim me gjobë, nga rrethanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një periudhë prej dy muajve, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

III. Të pandehurit **K.R.**, i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej 100 (njëqind) Euro, të cilin dënim me gjobë, nga rrethanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një periudhë prej dy muajve, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që të dëmtuarës DPBZHR –së, Zyra në Shtime t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 380.97 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata bazuar në nenin 453 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka liruar të pandehurit nga pagesa e paushallit gjyqësor dhe taksës në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1601-3/2019 e dt.12.09.2019, ka akuzuar të pandehurit S.R, N.R dhe K.R që të tre nga fshati ..., Komuna Shtime, të akuzuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale me datën 09.12.2019, mbajti shqyrtimin fillestar konform nenit 245 par.1 të KPPK-së, në të cilin kanë marrë pjesë pjesë prokuror i shtetit Avdullah Abedini të pandehurit S.R, N.R dhe K.R që të tre nga fshati ..., Komuna Shtime.

Të pandehurit, në shqyrtimin fillestar pasi janë udhëzuar në kuptim të nen. 246.1. të KPPK-së, dhe dorëzimin nga një kopje të aktakuzës dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në sallën e gjyqimit ka qëndrua i pandehuri i par kurse dy të tjerë janë larguar nga salla e gjyqimit dhe të pandehurit S.R, i është dhënë mundësia të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri S.R ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar pasi ka qenë së bashku me vëllezërit për të marrë dru për nevoja familjare drunjte të cilat i ka marrë nuk i ka prerë me qëllim të shitjes por për nevoja të familjes së tij, pasi është i gjendjes së varfër ekonomike dhe nuk ka pas mundësi që ti blej drutë, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese.

I pandehuri N.R ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është e vërtet se në pyll i ka takuar rojtari i pyllit por kushtet ekonomike e kanë bërë që të shkoj në pyll për të marrë dru pasi nuk kanë mundësi që ti blejnë.

I pandehuri K.R ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar me që kishin shkuar atë ditë në pyll ku me vete kishin edhe kalin dhe i kane lidhur drunjtë për tërheqje zhages ku janë hasur nga rojtari i pyllit dhe i njëjti ju ka marrë të dhënat personale krejt kjo ka ardhur për shkak të gjendjes jo të mire material të pa punë, ashtu lutem gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini ka deklaruar se pranohet pranimi i fajësisë së të akuzuarit mbështetet në aktin akuzues dhe provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit ta shpallë fajtor dhe gjatë shqiptimit të dënimit të akuzuarit të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë dhe gjendjen e tyre ekonomike.

Gjyqtari gjykues në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar konstatoj se i akuzuari pranimin e fajësisë e mbështeti në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë në fletëparaqitjen e rojës së pyllit i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Njësia e Pylltarisë Komuna Shtime me numër 36/2019 të

dt.16.08.2019, dhe procesverbalit nga komisioni i ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit të shkaktuar nr.35/19 i dt.02.09.2019 , dhe shkresat e tjera të lëndës.

Me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethane lehtësuese gjykata mori parasysh faktin se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, janë të gjendjes së dobët ekonomike, kanë theksuar se drutë i ka marrur për nevoja të familjes e jo për destinim shitje mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata me rastin e caktimit të dënimit secilit veç e veç dhe ju shqiptoj dënim me gjobë si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh gjendjen e tyre ekonomike dhe se kanë deklaruar se nuk janë duke punuar, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.1 të KPPRK-së ka obliguar të pandehurit që të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Njësia e Pylltarisë Komuna Shtime, t'a paguaj dëmin që e ka shkaktuar të precizuar në diapozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për lirim nga pagesa e paushallit gjyqësor dhe taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par.4 të KPPRK-së.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.980/2019 me datë 09.12.2019

Procesmbajtëse-praktikantja

Erza Shamolli

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.